

**AKT THEMELIMI
I
S H O Q E R I S E**

“ 2BM ” SHPK.

Sot, me daten 4 Dhjetor 2023 (dymije e njezetetre), unë shtetas :

Bledar Mëniku, shtetas shqiptar, i biri Dilaverit, i datëlindjes 12 dhjetor 1976, lindur dhe banues në Tiranë, madhor, me zotesi te plete juridike dhe per te vepruar, mbajes i Pashaportes nr BF1032402 dhe numër personal ID H61212110C, me vullnetin tim të lire të plete e të sinqerte, dhe inisiativen e lire private, mbeshtetur

Ne Kushtetuten e Republikës se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi,

Ne ligjin 9901 date 14.04.2008, “ Per tregetaret dhe shoqerite tregtare ”, Ne ligjin nr. 9723 date 03.05. 2007 “Per Qendren Kombetare te Regjistrimit”.

Ne ate Doganor, Fiskal e Tatimor, krijoj shoqerine tregtare, me ortak të vetem me perjegjesi të kufizuar **“2BM” SHPK.**

NENI 1

Shoqeria tregtare, formohet nga une ortaku i vetem me **“ 2BM ” SHPK.**, emer i cili do të jetë i stampuar dhe ne vulen e saj.

NENI 2

Selia juridike e Shoqërisë, ndodhet në Tiranë, Njësia Administrative Nr.8, Rr. “ Dervish Luzha ”, Zona Kadastrale Nr.8430, Pallatet “INERTI”, Ndërtesa A, Kati 6, Apartamenti 2, Kodi postar 1022, Tirane.

NENI 3

Shoqeria e shtrin aktivitetin e saj tregtar ne të gjithe juridikcionin territorial të Republikës se Shqiperise si dhe jashtë shtetit. Me vendim të ortakut te vetem, mund të krijohen ose anullohen (ne rast se jane celur) seli, filiale, agjensi dhe perfaqesi si ne qytete të tjera të Shqiperise dhe jashtë saj. Njesite e tjera strukturore të shoqerise si Dege apo perfaqesi dhe jashtë shtetit krijohen kur një gje të tillë parashikon dhe lejon dhe legjislacioni i vendeve të huaja, normat e se drejtës nderkombetare private dhe parimet e reciprocitetit tregtar mes vendeve të ndryshme.

NENI 4

Kapitali Themeltar i shoqerise eshte 100.000 leke (njeqindmije) lekë, i barabartë me vlerën një kuote, i zotëruar tërrësishët nga ortaku i vetëm Z.Bledar Mëniku. Ortaku i vetem ka pavaresi ligjore, organizative si dhe të drejta pronesie mbi cdo lloj kapitali, mjete xhiroje si dhe mbi cdo lloj pasurie tjeter të fituar ne rruge të ligjshme. Shoqeria per gjigjet vetem me kapitalin e saj.

NENI 5

Kapitali nuk mund të jetë kurre i perfaquesuar me letra me vlore dhe derdhja e kapitalit themeltar të shoqerise do te behet ne momentin e regjistrimit te saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit Tirane.

NENI 6

Kohezgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqerise eshte me afat te pakufizuar, duke filluar ky afat nga dita e marrjes se certifikates se regjistrimit nga Qendra Kombetare e Regjistrimit Tirane, per njojen dhe regjistrimin e shoqerise si person juridik.

Me vendim të Ortakut të vetem, kohezgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqerise mund të ndryshoje, dhe ky vendim i dergohet menjehere per depozitim Qendres Kombetare te Regjistrimit Tirane per të bere shenimet e nevojshme ne Regjistrin e Shoqerive Tregtare.

NENI 7

Shoqeria e zhvillon veprimtarine e saj tregtare ne perputhje të pote me Legjislacionin Shqiptar ne fuqi si dhe mbi bazen e ketij Akti Themelimi dhe Statutit të saj.

NENI 8

Shoqeria cel llogari bankare ne leke vendi dhe cdo lloj valute, ne Banka vendase ose të huaja, private apo shteterore, me qellim per të kryer veprimet e nevojshme per ushtrimin dhe perballimin financiar të aktivitetit të saj.

Ortaku i vetem dhe administratori i caktuar prej saj, depozitojne faksimilet e firmave të tyre orgjinale ne Bankat ku eshte celur llogaria dhe terheqja e pjeseve të saj behet kur ceku Bankar eshte firmosur nga ortaku i vetem dhe Administratori i shoqerise, ne rastin kur ortaku i vetem cakton një administrator dhe vetem me firmen e ortakut të vetem, kur ky vete kryen njekohesisht dhe detyren e Administratorit të Pergjithshem të shoqerise.

NENI 9

Pjeset e kapitalit themelor, jane lirisht të transferueshme ne rruge trashegimie sipas dispozitave të Kodit Civil. Ortaku i vetem, ka të drejtë të transferoje jashte territorit të Republikës se Shqiperise pjeserisht apo teresisht kontributet e saj perfshire dhe fondet dhe kontributet e pjeseve të kapitalit themelor, duhet të jene të vertetuara me Akt Notarial dhe per një gje të tille ortaku i vetem duhet të marre paraprakisht vendim me shkrim.

Shoqeria dhe të tretet duhet të respektojne keto transferime sapo t'u behen të ditura..

NENI 10

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte :

Punime ndertimi,germim dheu,montim,projektim,restaurim,ndertime objekte civile industriale dhe sociale.Studim,projektim ,ndertim hidrocentrale,prodhim shitje energjie elektrike.Investime ne fusha te ndryshme.Punime te ndryshme dhe te specializuara ne fushen e ndertimit.Pastrim dhe gjelberim ,printim dhe publikim,trajnime te ndryshme,sherbime hidraulike,sherbime elektrike ndertim konstruksione metalike dhe druri.Trasport per vete dhe per te trete. Perkthime. Tregeti shumice-pakice e mallrave dhe materialeve te ndryshme te ndertimit,riparim-sherbim ashensore e gjeneratore,turbina,mirembajte ,sherbime te ndryshme. Agjensi imobiliare.Agjensi turistike.Agjensi doganore.Import-eksport dhe tregetim me shumice dhe pakice te materialeve dhe produkteve te ndryshme industriale.Sherbime juridike dhe konsulenca juridike.Ndermjetesim per investime dhe investitore te vendit dhe te huaj.

NENI 11

Me vendim të ortakut të vetëm, shoqëria mund të zgjerojë aktivitetin e saj tregtar dhe në drejtime të tjera të cilat janë me interes për mbarvajtjen e shoqërise apo mund te zvogëloje atë.

NENI 12

Me vendim të ortakut të vetëm, shoqëria mund të zgjerohet duke pranuar një ose më shume ortakë të tjere, shtetas shqiptarë apo të huaj, ose të bashkohet me një shoqëri tjeter tregtare si brenda vendit dhe jashtë saj.

NENI 13

Ortaku i vetëm është Organi me i Lartë Drejtues dhe Vendimor i shoqërisë dhe ai ushton të gjitha kompetencat që ligji " Per tregtarët dhe shoqëritë tregtare " i njeh amblese së ortakëve që janë krijuar me ortakëri.

Ortaku i vetëm mund t'ia delegojë kompetencat një ose me shumë administratorëve të caktuar prej tij ose dhe një personi fizik jashtë ortakerisë së shoqërisë, vetëm mbi bazën e prokurës.

NENI 14

Administrator I shoqerisë "2BM" SHPK Z. Bledar Mëniku, I biri Dilaverit I datëlindjes 12 dhjetor 1976, mbajtës I dokumentit të identitetit me numër 035615587 dhe Numër Personal H61212110C, lindur në Tiranë dhe banues në Tiranë, Njësia Administrative Nr.8, Rr. " Dervish Luzha", Zona Kadastrale Nr.8430, Pallatet "INERTI", Ndërtesa A, Kati 6, Apartamenti 2, Kodi postar 1022. Z. Bledar Mëniku, emërohet në këtë detyrë për një periudhë 5 vjecare, me të drejtë ripërtëritje.

NENI 15

Ky akt themelimi u redaktua ne 3 ekzemplare, vetem ne gjuhen shqipe, me permbajtje dhe vlera të njejta juridike dhe ai eshte I vlefshem kur ne të gjithe faqet e tij eshte vene firma orginale e ortakut themelues.

THEMELUES I SHOQERISE TREGTARE "2BM SHPK.

Bledar Mëniku
Gjyku

Bledar Mëniku

**STATUT
I
SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

“ 2BM ” SHPK.

KREU I :

EMERTIMI- OBJEKTI- SELIA- KOHEZGJATJA

NENI 1

Sot, me daten 4 Dhjetor 2023 (dymije e njezetetre), unë shtetasi :

Bledar Mëniku, shtetas shqiptar, i biri Dilaverit, i datëlindjes 12 dhjetor 1976, lindur dhe banues në Tiranë, madhor, me zotesi te plete juridike dhe per te vepruar, mbajtes i Pashaportes nr BF1032402 dhe numër personal ID H61212110C, me vullnetin tim të lire të plete e të sinqerte, dhe inisiativen e lire private, mbeshtetur

Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe Kodin Civil në fuqi,

Në ligjin 9901 datë 14.04.2008, “ Për tregëtaret dhe shoqëritë tregëtare ”,

Në ligjin nr. 9723 datë 03.05. 2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

Ne aktin e themelimit te shoqerise hartohet sot statuti i shoqërisë tregtare, me përgjegjësi të kufizuar emërtuar

“ 2BM ” SHPK.

Në këtë statut :

“ Ligj” do të nënkuftojë ligjin nr. 89901 datë 14.04.2008 “ Për tregëtarët dhe shoqëritë tregëtare ”
“asambleja e ortakëve” do të thotë të gjithë ortakët e shoqërisë dhe do të përdoret edhe për termin “ ortak i vetëm ”

NENI 2

Kjo shoqëri tregëtare është shoqëri vendase dhe emërtohet **“ 2BM ” SHPK** emërtim i cili do të jetë i stampuar dhe në vulën e saj.

NENI 3

Shoqëria ka selinë e saj në adresen : **Tirane,Rruga Dervish Luzha,Pallati Inerti,Shk.2,Kati 6,Ap.2.**

Ortaku i vetem/ asambleja e shoqërisë, mund të krijojë seli të reja dytësore ose të çojë selinë ligjore jashtë rrethit Tiranë, dhe në të gjithë territorin e Shqipërisë, madje te hape filiale jashtë saj.

NENI 4

Shoqëria e shtrin te gjithe aktivitetin e saj në të gjithe juridiksionin territorial të Republikës së Shqipërisë si dhe jashtë shtetit.

Me vendim të Ortakut/ortakëve, mund të krijohen ose anullohen (në rast se janë celur), seli, filiale, agjensi dhe përfaqësi si në qytete të tjera të Shqiperisë dhe jashtë saj.
Gjithashtu, shoqëria mund të përfshihet në shoqëri të tjera shqiptare apo të huaja, apo të krijojë përfaqësi të tyre në territorin e Shqipërisë apo jashtë saj konform legjislacionit në fuqi.

Njësitë e tjera strukturore të shoqërisë si Degë apo përfaqësi dhe jashtë shtetit krijojen kur një gjë të tille parashikon dhe lejon dhe legislacioni i vendeve të huaja, normat e së drejtës ndërkombëtare private dhe parimet e reciprocitetit tregtar mes vendeve të ndryshme.

NENI 5

Kapitali themeltar është 100 000 (njeqind mijë) lekë.

Ortaku i vetëm i shoqërisë Z.BLEDAR MËNIKU, zotëron tërësisht kapitalin themeltar të shoqërisë, të përbërë nga një kuotë.

Ortaku/ët ka pavarësi ligjore, organizative si dhe të drejta pronësie mbi cdo lloj kapitali, mjete xhiroje si dhe mbi cdo lloj pasurie tjetër të fituar dhe që do të fitohet në rrugë të ligjshme. Shoqëria pergjigjet vetëm me kapitalin e saj.

Ortaku/ët mund të ndryshojë kontributet në kapitalin themeltar të shoqërisë në kohë dhe në vlerë me vendim të ortakut të vetëm apo asamblesë së ortakëve.

Të gjitha kontributet që do të derdhen cash në kapitalin e shoqërisë do të bëhen vetëm nëpërmjet transfertave bankare në llogarinë e shoqërisë, në monedhen që do të vendosin vetë ortakët .

Ortaku/ortakët ka të drejtë të përfitojë një certifikatë për kuotën e zotëruar prej tij.

Me miratim të asamblesë së ortakëve kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet në vlerë, në natyrë apo me cfarëdolloj mënyre që parashikon ligji shqiptar.

NENI 6

Kapitali nuk mund të jetë kurre i përfaqësuar me letra me vlerë dhe derdhja e kapitalit themeltar të shoqerise, bëhet sipas ligjit.

NENI 7

Kohëzgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqerise është me afat të pakufizuar.

Me vendim të Asamblesë së Ortakëve, kohëzgjatja e ushtrimit të aktivitetit të shoqerise mund të ndryshojë, dhe ky vendim i dërgohet menjëherë për depozitim Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

NENI 8

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte :

- Punime ndertimi,germim dheu,montim,projektim,restaurim,ndertime objekte civile industriale dhe sociale.Studim,projektim ,ndertim hidrocentrale,prodhim shitje energjie elektrike.Investime ne fusha te ndryshme.Punime te ndryshme dhe te specializuara ne fushen e ndertimit.Pastrim dhe gjelberim ,printim dhe publikim,trajnime te ndryshme,sherbime hidraulike,sherbime elektrike ndertim konstruksione metalike dhe druri.Trasport per vete dhe per te trete.Perkthime.Tregeti shumice-pakice e mallrave dhe materialeve te ndryshme te ndertimit,riparim-sherbim ashensore e gjeneratorë,,turbina,mirembajte ,sherbime te ndryshme. Agjensi imobiliare.Agjensi turistike.Agjensi doganore.Import-eksport dhe tregetim me shumice dhe pakice te materialeve dhe produkteve te ndryshme industriale.Sherbime juridike dhe konsulencia juridike.Ndermjetesim per investime dhe investitore te vendit dhe te huaj.

NENI 9

Shoqëria e fiton personalitetin e saj juridik nga data e regjistrimit ne në Qendrën Kombëtare të Bisnesit.

NENI 10

Shoqëria e zhvillon veprimitarinë e saj tregëtare në përputhje të plete me Legjislacionin Shqiptar në fuqi, atë Tregtar, Civil, Doganor, Tatimor, Fiskal dhe aktet e tjera ligjore e nënligjore specifike për ushtrimin e saj, sipas objektit të veprimitarisë së saj, mbi bazën e Aktit të Themelimit dhe Statutit të saj dhe normat e së drejtës tregëtare ndërkombe.

KREU II: KUSHTET EKONOMIKE

NENI 11

Shoqëria cel llogari bankare në lekë vendi dhe cdo lloj valute, në Banka vendase ose të huaja, private apo shtetërore, me qëllim për të kryer veprimet e nevojshme për ushtrimin dhe përballimin financiar të aktivitetit të saj.
Asambleja e Ortakëve dhe administratori i caktuar prej saj, depozitojnë faksimilet e firmave të tyre orgjinale në Bankat ku është celur llogaria .

NENI 12

Pjesët e kapitalit themelor, janë lirisht të transferueshme në rrugë trashëgimie sipas dispozitave të Kodit Civil dhe atij Tregtar.

Ortaku i vetëm/ asambleja e ortakëve ka të drejtë të transferojë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë pjesërisht apo tërësisht kontributet e saj përfshirë dhe fondet e Kontributet në natyrë. Transferimet e pjesëve të kapitalit themelor, duhet të jenë të vërtetuara me akt notarial dhe për një gjë të tille ortakët duhet të marrin paraprakisht vendim me shkrim. Shoqëria dhe të tretë duhet të respektojnë këto transferime sapo tu bëhen të ditura.

NENI 13

Kapitali Themeltar i shoqërisë mund të rritet ose zvogelohet, mbi bazën e vendimit me shkrim që merr ortaku i vetëm/ Asambleja e Ortakëve, i cili nënshkruhet prej tij dhe dokumentohet duke bërë dhe shenimet në regjistrin përkatës.

Me vendim të ortakut të vetëm/Asamblesë së Ortakëve ai ka të drejten që një pjesë të kuotave të kapitalit themeltar t'ja tjetërsojë një apo disa personave fizikë jashtë ortakërisë ose personave juridikë, vendas apo të huaj mbi bazën e aktit notarial, duke ju ceduar atyre dhe të drejten e qenies ortak në raport me pjesën e kuotave të kapitalit të tjetersuar.

Cdo vendim i ortakut të vetëm/Asamblesë së Ortakëve për ndryshimin e kapitalit themeltar i dërgohet menjëherë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit që e ka njojur dhe rregjistruar shoqërinë si person juridik.

KREU III :

ORGANET DREJTUESE TË SHOQERISE DHE TË DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKUT/ORTAKEVE

NENI 14

Ortaku i vetëm/Asambleja e Ortakëve është Organi më i Lartë Drejtues dhe Vendimor i shoqërisë dhe ai ushtron të gjithe kompetencat që ligji " Për tregëtarët dhe shoqërite Tregtare " i njeh asamblesë së ortakëve .

Ortaku i vetëm/ Asambleja e Ortakëve mund t'ja delegojë kompetencat një ose më shumë Administratorëve të caktuar prej saj ose dhe një personi fizik jashtë ortakerisë së shoqerisë, vetem mbi bazën e prokurës.

NENI 15

Me vendim të ortakut të vetëm/Asamblesë së Ortakëve shoqëria mund të zgjerohet duke pranuar një ose më shumë ortakë të tjere, shtetas shqiptare apo të huaj, ose të bashkohet me një shoqëri tjeter tregëtare si brenda vendit dhe jashtë shtetit.

NENI 16

Ortakët e shoqerisë kanë dhe këto të drejta dhe detyra kryesore :

1. përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
2. ndryshime të statutit;
3. miratimi i rregulloreve të Brendshme të shoqërisë si dhe ndryshimi i tyre;
4. emërimi e shkarkimi i administratorëve;
5. emërimi e shkarkimi i likuiduesve dhe ekspertëve kontabël të autorizuar;
6. përcaktimi i shpërblimeve për personat e përmendur ne pikat 4 dhe 7.
7. mbikëqyrja e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshi përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se aktivitetit;
8. miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe i raporteve të ecurisë se aktivitetit;
9. shpërndarja e fitimeve vjetore;
10. pjesëtimi i kuotave dhe anulimi i tyre;
11. përfaqësimi i shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratoreve;
12. riorganizimi dhe prishja e shoqërisë;
13. miratimi i rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
14. çështje të tjera te parashikuara nga ligji.
15. Asambleja e Përgjithshme merr vendime në lidhje me pikat 7 dhe 8 të këtij neni pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës.
16. Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm/asambleja e ortakëve regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilët nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet e mëposhtme:
17. miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se aktivitetit;
18. shpërndarja e fitimeve vjetore dhe mbulimi i humbjeve;
19. vendimet për investime;
20. ndryshimet e statutit, riorganizimi dhe prishja e shoqërisë.
21. Te gjitha vendimet e ortakut të vetëm/asamblese se ortakeve duhet te depozitohet ne Qendren Kombëtare te regjistrimit të shoqërisë.
22. Në përputhje me të drejtat ose kufizimet që rrjedhin nga kuotat, cdo kuotë I jep ortakut apo përfaqësuesit me procure të tij, të drejtën e një vote.

NENI 17

ADMINISTRIMI, ADMINISTRATORI , KOMPETENCAT

Përfaqësimi i shoqërisë në mardhëni me të tretët si brenda dhe jashtë shtetit si rregull dhe përgjithësisht i përket administratorit.

Administratori

Administrator i shoqërise emerohet:

Z. Bledar Mëniku, shtetas shqiptar, i biri Dilaverit, i datëlindjes 12 dhjetor 1976, lindur dhe banues në Tiranë, madhor, me zotesi te plote juridike dhe per te vepruar, mbajtes i Pashaportes nr BF1032402 dhe numër personal ID H61212110C. Me adresë: Njësia Administrative Nr.8, Rr.“ Dervish Luzha”, Zona Kadastrale Nr.8430, Pallatet “INERTI”, Ndërtesa A, Kati 6, Apartamenti 2, Kodi postar 1022, Tirane.

Z. Bledar Mëniku emerohet në këtë detyrë për një mandat 5 (pesë) vjeçar.

Emër Mbiemër

Bledar Mëniku

Nënshkrimi

S. Jashari

Me vendim te asamblesë së ortakëve administratori ndryshohet ne cdo 5-vjet, dhe ka të drejtën të rizgjidhet.

Afat i ndryshimit të administratorit mund të ndryshohet me vendim të ortakut të vetëm/asamblesë së ortakëve dhe ky vendim, si dhe vendimi i asamblesë për emërimin e cdo administratori detyrimisht do të regjistrohet ne Qendrën Komëtare të Regjistrimit.

Administratori/ët, kanë të drejte e detyrohen të:

1. kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të aktivitetit tregtar të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme;
2. përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
3. kujdesen për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe librave kontabël të shoqërisë;
4. përgatisin dhe nënshkruanjë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së aktivitetit, dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, të paraqesin këto dokumente përpara ortakut të vetëm/Asamblesë së Përgjithshme për miratim;
5. krijojnë një sistem të paralajmërimit ne kohën e duhur në lidhje me rrethanat që kërcënojnë mbarëvajtjen e aktivitetit dhe ekzistencën e shoqërisë;
6. kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, sic parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
7. raportojnë përpara ortakut të vetëm/Asamblesë së Përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për aktivitetin e shoqërisë tregtare;
8. kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në Ligj dhe në Statut.
9. Administratorët janë të detyruar të thërrasin dhe organizojne mbledhjet e Asamblesë se Përgjithshme.
10. Nëse ortaku I vetëm/Asambleja e Përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë. Rregulloret e tjera të miratuara nga Asambleja e Përgjithshme mund të parashikojnë ndryshe.
11. Ortaku I vetëm/Asambleja e Përgjithshme mund të shkarkojet administratorin në çdo kohë, me shumicë të zakonshme. Asnjë marrëveshje nuk mund të përjashtojë apo kufizojë këtë të drejtë. Paditë që lidhen me shpërblimin e administratorit në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas kodit te punes.
12. Ne rastin e Keshillit te administrimit, perfaqësuesi ligjor eshte administratori. Ne rast se shoqeria funksionon me një administrator te vetem atehere administratori eshte perfaqësuesi ligjor i shoqerise ndaj te treteve.
13. Tagrat e përfaqësimit të administratoreve dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Përfaqësimi ligjor dhe firma i përket administratorit , të cilit i përket gjithashtu:

- a) Detyra për ta thirrur, në çfarëdolloj forme me shkrim ose me gojë,
- b) për të udhëhequr dhe drejtuar mbledhjet,
- c) për të mbajtur procesverbalet e vendimeve, ose për t'u ndihmuar për këtë nga një sekretar i emëruar herë pas here.

NENI 18

Ortaku i vetëm/ Asambleja e Ortakëve dhe administratori i shoqërisë, kanë të drejte që për nevojat e ushtrimit normal të aktivitetit të shoqerise, të marrin në punë shtetas të ndryshëm, madhorë dhe me zotesi të plotë për të vepruar, duke lidhur kontratë sipas kritereve që parashikohen ne Kodin e Punës me ligjin “ Për sigurimet shoqërore “ si dhe në përshtatje me rregullat e brendëshme të disiplines teknike dhe të punes të caktuara nga vetë punëdhënësi.

KREU IV

BILANCI, TË ARDHURAT DHE SHPERNDARJA E SHOQERISE

NENI 19

Veprimet ekonomiko financiare të shoqërisë, mbyllen më daten 31 Dhjetor të cdo viti. Për nxjerrjen e rezultatit kontabël të shoqërisë, mbi bazën e aktivit dhe pasivit ngarkohet nga Ortaku i vetëm/Asambleja e Ortakëve një ekspert kontabël i miratuar ose i autorizuar.

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqerisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tille i ngarkuar nga ana e ortakut të vetëm.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabël i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit finanziar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ja paraqesë e dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që kanë.

NENI 20

Nxjerra e rezultateve të Bilancit vjetor duhet bërë me saktësi dhe duke respektuar të gjitha rregullat që përcaktohen në Ligjin mbi Kontabilitetin dhe atyre të Sistemit të Taksave, që janë të detyrueshme për tu zbatuar nga cdo subjekt privat, që ushtron veprimitari tregtare.

NENI 21

Bilanci Kontabël vjetor, miratohet mbi bazën e vendimit me shkrim nga ortakët, i cili jo vetëm që dokumenton miratimin e tyre por vendos në lidhje me disponibilitetin e fondeve ligjore sipas nevojave të zhvillimit të mëtejshëm të shoqërisë dhe garantimin e veprimtarisë së rregullt të saj, duke pasur parasysh fondin e akumulimit, krijimin e fondit të vecantë etj.

NENI 22

Të ardhurat neto (Dividenti) që mbeten pas vecimit të fondeve ligjore të mësipërme dhe të atyre për shlyerjen e cdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të tretëve, i mbesin dhe i kalojnë në pronësi, ortakëve të shoqërisë.

NENI 23

Shperndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në cdo kohë dhe për cfarëdo shkaku, edhe para plotësimit të afatit për të cilin eshtë krijuar sic mund të jenë :

- a) Humbja e kapitalit ose pamundësia e vazhdimit të mëtejshëm të veprimtarisë së saj.
- b) Në një nga mënyrat e parashikuara nga ligji “ Për Falimentimin e Shoqërise Tregtare”
- c) Kur plotësohet afati i caktuar për ushtrimin e veprimtarise tregtare.
- d) Për cdo rast me vendim të asamblesë së ortakëve.

Në këtë rast ortaku i vetëm/Asambleja e Ortakeve merr vendim me shkrim në të cilin parashikon mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatorë dhe shënuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtesë “ Shoqëri në likuidim e sipër ”.

NENI 24

Afati i emërimit të likuidatorit, publikohet sipas kushteve që parashikon ligji përkatës duke specifikuar dhe dokumentat që duhen depozituar në Aneksin e Regjistrat Tregtar.

NENI 25

Likuidatori eshtë i detyruar që të jetë i vëmendshëm dhe korekt, si për realizimin e të drejtave për subjektet ndaj të cilëve shoqeria eshtë kreditore dhe për ekzekutimin e detyrimeve debive që shoqeria ka ndaj shtetit, shtetasve të vecantë apo personave fizikë apo juridikë vendas apo të huaj.

NENI 26

Cdo mosmarrvëshje apo konflikt që mund të lind gjatë ushtrimit të veprimtarisë së Shoqërisë si rregull dhe përgjithësisht ortaket duhet ta zgjidhin me mirëkuptim, në të kundërtën cështja mund të bëhet objekt konflikti gjyqësor në Gjykates e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 27

Përsa nuk eshtë shprehur në këtë statut, i referohet udhëzimeve plotësuese dhe të ligjshme të dhëna nga ortaku i vetëm/Asambleja e Ortakëve si dhe legjislacioni në fuqi.

NENI 28


Ky statut u redaktua ne 3 ekzemplarë me përbajtje dhe vlera të njëjta juridike, në gjuhën shqipe dhe pasi miratohet në parim dhe nen për nen nga Ortaku i vetëm i shoqerisë tregtare “ **2BM** ” SHPK. nënshkruhet prej tij.

ORTAKU I VETËM

I SHOQERISE

“ **2BM** ” SHPK.

BLEDAR MËNIKU



Page 10 of 10

“ **2BM** ” SHPK.